



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për:** Operatorin ekonomik "INA" sh.p.k me NIPT J61814009W, me administrator Z. Ferdinand Çausi, me seli në Adresën: Tirane Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit.

**Lloji i procedurës së prokurimit:** "Procedurë e hapur"

**Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** "Rikonstruksion rrjet ujesjellesi ne rrugen:"Bedri Karapici", "Hamdi Pepa"

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-24534-05-30-2019

**Fondi limit:** 21.129.664 (njëzet e një milion e njëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 45 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 02.07.2019 Ora: 11:00

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr. 22 DATE 03.06.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "INA" shpk NIPT-I J61814009W  
Vlera: 18.674.926 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzetë e jashtë)lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik BO"Kombeas"sh.p.k NIPT-i K88103301J  
&Griald"sh.p.k NIPT-i J68117216S  
Vlera: 20,067,191(njëzetë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një)lekë pa tvsh

3. Operatori ekonomik “Senka” shpk

NIPT-i J94808405Q

Vlera: 20,977,076 (njëzetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH.

**Të skualifikuar:**

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” sh.p.k me vlerë **20,977,076** (njëzetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ pika 2 g)si më poshtë cituar:

*d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Në përmbushje të kriterit të sipërcituar “Senka” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

*“Vërtetim debie” nr. 713 prot, date 01.06.2019 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuesit “Senka” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 01.06.2019 pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj.*

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Maj 2019.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “g” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, [info@ukt.al](mailto:info@ukt.al).

*Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 30.05.2019 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 02.07.2019 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit maj 2019 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimit gjykatë”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

e) deklaratën mbi disponueshmëinë e mjeteve sipas shtojcës 10.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik konstaton se shtojca 10 (mbi disponimin e makinerive) rezulton të jetë për një tjetër objekt prokurimi dhe përkatësisht për objektin **“Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga Blv. Bajram Curri-Blv. Petro N. Luarasi-Rruga Ali Demi-Faza I”**.

Në shtojcën 12 shprehimisht parashikohet se .....Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rrëmë e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga **BO”Kombeas”sh.p.k &Griald”sh.p.k** me vlerë **20,067,191**(njëzetë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një)lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari Autoriteti Kontraktor në shtojcën 9 /Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë:

a) Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të dorëzohen:

Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi I operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht

b) Prokurë e posaçme

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik komisioni i Vlerësimit të Ofertave konsaton se në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur BO” Kombeas”sh.p.k &Griald”sh.p.sh.p.k kanë paraqitur kontratën e bashkëpunimit me nr.Rep 4818 ,Kol 3372 datë 28.06.2019 ku janë përcaktuar përqindjet e bashkëpunimit, nga të cilat evidentohet se operatori ekonomik “Kombeas”sh.a ka marrë përsipër 51% të punimeve si dhe operatori ekonomik Griald sh.p.k I cili ka marre

persiper 49 % të punimeve .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KVO konstaton se në kontratën e bashkëpunimit si dhe në preventivin e ofertës, bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk kanë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët konkretë të punës që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Referuar nenit 74 pika 1 të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet ....*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. **Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.***

Po kështu në nenin 74 pika 2 të VKM-së 914 “Për Miratimin e Rregullave të Miratimit Publik”, I ndryshuar shprehen qartë elementët që duhet të përmbajë kontrata e bashkëpunimi të cilat janë:

**Bashkimi krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar ku të përcaktohen përfaqësuesi I grupit , përqindja e pjesmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkret që duhet të kryejnë secili nga anëtarët e bashkimit.**

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, në kontratën e bashkëpunimit operatorët ekonomikë duhet të ndajnë dhe përcaktojnë jo vetëm punët në përqindje, **por edhe elementët konkretë të punëve që do të kryejë secili operator ekonomik anëtar i bashkimit të përkohshëm, gjë e cila nuk është plotësuar nga bashkimi i operatorëve në përputhje me përcaktimin ligjor si më sipër cituar.**

Përsa cituam më sipër Bashkimi Operatorëve ekonomikë të mësipërm nuk e kanë përmbushur kriterin e kërkuar në shtojcën 12 të DST pasi në kontratën e bashkëpunimit nuk janë përcaktuar **elementët konkret në përputhje me bazën ligjore në fuqi.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu sqarojmë se nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP në të cilin përcaktohet se “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”, pasi sqarimet mund të kërkohej vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik “INA” sh.p.k me NIPT J61814009W, me administrator Z. Ferdinand Çausi, me seli në Adresën: Tirane Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, me vlerë të ofertës: 18.674.926 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nënëtdëqind e njëzetë e jashtë)lekë pa TVSH., se **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, [info@ukt.al](mailto:info@ukt.al).

2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.07.2019

**Ankesa:** Nuk ka patur.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**REDI MOLLA**